



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

REPUBLICA E KOSOVES/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI-CORRUPTION AGENCY

Nr. Prot. 01-1091/15
Br. Prot. 01-1091/15
Prot No. 01-1091/15
Data 10-04-2015
Datum 10-04-2015

Nr. l faq. 02
Drej. Stranica 02
Nr. pages 02

PRISHTINE

DATE/A:	10.04.2015
REFERENC-Ë:	AKK-DPKPP
PËR/ZA/TO:	z. Nuro ISMAILI Menaxher i Prokurimit në Komunën e Dragashit
CC:	z. Salim JENUZI Kryetarë i Komunës së Dragashit
NGA/OD/FROM:	z. Hasan PRETENI Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Opinion lidhur me Tenderin me titull " Kubëzimi i rrugëve në fshatin Shanje-K.K. Dragash "

I nderuari z. ISMAILI,

Në mbështetje të nenit 5 paragrafi 1 nën paragrafi 1.12 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit dhe nenit 19 paragrafi 1 nën paragrafi 1.6 të Ligjit nr. 04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik, lidhur me Tenderin " **Kubëzimi i rrugëve në fshatin Shanje-K.K. Dragash** " me numër prokurimi: 621 15 04 521 Agjencia kundër Korrupsionit, ofron këtë:

OPINION

Me të cilin kërkohet nga ju si Autoritet Kontraktues që t'i ndërmerrni të gjitha veprimet e nevojshme për evitimin e shkeljeve të evidentuara në lidhje me Tenderin " **Kubëzimi i rrugëve në fshatin Shanje-K.K. Dragash** " me numër prokurimi: 621 15 04 521, në mënyrë që të respektohen dispozitat përkatëse të Ligjit nr. 04-L/042 për Prokurimin Publik

A r s y e t i m

Komuna e Dragashit si Autoritet kontraktues, përmes Departamentit të Prokurimit ka përgatitë njoftimin për kontratë me titull " **Kubëzimi i rrugëve në fshatin Shanje-K.K. Dragash** " me numër prokurimi: 621 15 04 521, e cila është publikuar në faqen elektronike të KRPP-së me dt.19.03.2015 në Procedurë të Hapur. Agjencia kundër Korrupsionit, sipas detyrës zyrtare ka identifikuar këtë procedurë të prokurimit si lëndë për trajtim. Gjatë trajtimit dhe ekzaminimit të dokumentacionit lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, Agjencia kundër Korrupsionit ka hasur në disa të dhëna të cilat janë në kundërshtim me Legjislacionin në fuqi i cili e rregullon fushën e Prokurimit Publik në Republikën e Kosovës.

Në njoftimin për kontratë i cili është publikuar në faqen elektronike të KRPP-së, me datë 19.03.2015 tek rubrika III.2.4) Kapaciteti teknik dhe profesional pika 1. **Ka kërkuar Referenca. Dëshmia e kërkuar: Referencat e natyrës së njejtë të punëve-(Lista e projekteve të realizuara, të bashkëngjiten dhe kontratat e tyre).** kërkesa këto të cilat konsiderojmë se bien ndesh me Legjislacionin në fuqi për Prokurimin Publik.

Bazuar në legjislacioni në fuqi për Prokurim Publik, një Autoritet Kontraktues ka të drejtë që në kuadër të kritereve të përzgjedhjes të kërkoj si dëshmi kontrata dhe referenca me të cilat do ta vërtetonte Kapacitetin teknik dhe profesional të operatorëve ekonomik, mirëpo nëse e vendos një kërkesë të tillë, për ta vërtetuar aftësinë teknike dhe profesionale të OE-ve, atëherë detyrimisht këto kontrata dhe referenca duhet ti kërkoj në tri vitet e fundit (2012,2013 dhe 2014) .

Veprimet e Autoritetit Kontraktues konsiderojmë se bien ndesh me nenin **69** Aftësia Teknike dhe Profesionale të Ligjit për Prokurimin Publik Nr.04/L-042,dhe nenin **23** Kriteret e Përzgjedhjes të Udhëzuesit Operativ për Prokurim Publik.

Konsiderojmë se shkelje të tilla, nuk duhet lejuar në procedura të prokurimit, andaj AKK rekomandon anulimin e kësaj procedure të prokurimit dhe kërkon nga Autoriteti Kontraktues që të shmang praktikat e tilla në të ardhmen.

Autoritetet Kontraktuese e informojnë Agjencinë për veprimet e ndërmarra.

Me respekt !